



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2021:259949
Datë: 29.04.2024
Numri i dokumentit: 05631798
KPPP.nr.23/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtarja Verona Dibra, në çështjen përmbareme të kreditorit Komisioni i Pavarur i Mediave, me seli në Prishtinë, rruga “Perandori Justinian”, nr.124, kundër debitorit “Kujtesa Net” SH.P.K., K-Film Tre, me NRB 70249238, me seli në Prishtinë, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbareme P.nr.859/17 të datës 18.12.2017, të Përmbaremit Privat Destan Bujupaj, me seli në Prishtinë, jashtë seancës me datën 29.04.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

PRANOHET si i bazuar prapësimi i debitorit “Kujtesa Net” SH.P.K., K-Film Tre, ANULOHET urdhri përmbareme P.nr.859/17 i datës 18.12.2017, i lejuar nga Përmbaremi Privat Destan Bujupaj dhe PËRFUNDOHET në tërësi përmbaremi në këtë çështje përmbareme.

A r s y e t i m

Përmbaremi Privat Destan Bujupaj, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit Komisioni i Pavarur i Mediave ka caktuar urdhrin P.nr.859/17 të datës 18.12.2017, duke lejuar përmbaremin në bazë të dokumentit të besueshëm Faturës Nr.001180 të datës 03.03.2016, me të cilin e ka urdhëruar debitorin “Kujtesa Net” SH.P.K., që të ia paguaj kreditorit në emër të borxhit të përcaktuar sipas faturës shumë prej 1,890.00 €, si dhe shpenzimet e procedurës përmbareme në pajtim me Udhëzimin Administrativ UA-MD Nr.06/2014, nën kërcënimin të përmbaremit të dhunshëm dhe pasojave tjera ligjore.

Debitori në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor e ka kundërshtuar urdhrin përmbareme duke theksuar se fatura në bazë të së cilës është lejuar urdhri nuk është e

nënshkruar nga ana e debitorit, nuk përmban emrin e debitorit, adresën e debitorit, numrat fiskal apo të biznesit dhe nuk udhëzon për kohën brenda së cilës duhet të përmbushet e njëjta. Më tutje ka shtuar se fatura nuk i përmban elementet dërrmuese të një dokumenti të besueshëm të paraparë sipas LPP-së, që duhet të plotësohen në mënyrë kumulative, e ku mungesa e tyre paraqet shkak për paraqitjen e prapësimit dhe bazë për anulimin e urdhrin përmbarimor në bazë të nenit 71 par.1.1 i LPP-së. Ka theksuar se dokumenti i pretenduar si faturë është lëshuar në emër të pagesës për licencë, ndërsa në rastin konkret debitori në dhjetor të vitit 2015, kishte njoftuar kreditorin se heq dorë nga të gjitha licencat dhe mban aktive vetëm 5 nga to, ndërsa fatura është lëshuar për licencën të cilën debitori e ka revokuar. Gjykatës i ka propozuar që të aprovoj në tërësi kundërshtimin e debitorit si të bazuar, të anuloj urdhrin përmbarimor dhe të gjitha veprimet e kryera në këtë procedurë, si dhe të detyrohet kreditori që debitorit të ia kompensoj shpenzimet procedurale.

Kreditori në përgjigjen në prapësim i ka kundërshtuar në tërësi pretendimet e debitorit të paraqitura në prapësim duke shtuar se urdhri për përmbarim është lejuar sipas faturës e cila i plotëson të gjitha elementet e parapara për secilën Organizatë Buxhetore. Sa i përket heqjes dorë nga licenca, ka deklaruar se debitori ka qenë në dijeni që për heqjen dorë nga licenca për kanalet e licencuara duhet të dorëzohet kërkesë me shkrim në KPM dhe se deri në marrjen e vendimit nga KPM në lidhje me kërkesën për heqje dorë nga licenca, debitori konsiderohet operator i licencuar dhe bart të gjitha obligimit sipas Ligjit dhe akteve nënligjore të KPM. Tutje ai ka shtuar se debitori nuk e ka parashtruar asnjë dëshmi me të cilën e argumenton se nuk ka borxh ndaj kreditorit, andaj në këtë bazë, prapësimi i debitorit nuk bazohet në asnjërin nga shkaqet e prapësimit të paraparë me nenin 71 të LPP-së. Gjykatës i ka propozuar që të refuzohet në tërësi prapësimi i debitorit dhe urdhri përmbarimor të mbetet në fuqi.

Gjykata Komerciale e Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, lidhur me këtë çështje përmbarimore me Aktvendimin KPPP.nr.421/22 të datës 09.12.2022, ka pranuar si të bazuar prapësimin e debitorit dhe ka anuluar urdhrin përmbarimor P.nr.859/17 të datës 18.12.2017.

Kreditori me datën 10.01.2023, ka paraqitur ankesë kundër Aktvendimit KPPP.nr.421/22 të datës 09.12.2022, të Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, me të cilën e ka kontestuar në tërësi aktvendimin e atakuar, me propozim që të aprovet ankesa e kreditorit dhe të anulohet Aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, KPPP.nr.421/22 i datës 09.12.2022, duke lënë në fuqi urdhrin përmbarimor.

Gjykata Komerciale e Kosovës - Dhomat e Shkallës së Dytë, me Aktvendimin K.DH.SH.II.nr.356/23, të datës 25.05.2023, ka aprovuar si të themeltë ankesën e kreditorit dhe ka anuluar aktvendimin KPPP.nr.421/22 të datës 09.12.2022, të Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, dhe lënda i është kthyer të njëjtës në rishqyrtim dhe rivendosje.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, kundërshtimeve të kreditorit nga përgjigjja në prapësim, shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, vërejtjeve sipas aktvendimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkallës së dytë dhe duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore, (tutje LPP) dhe nenit 12 par. 2 të Ligjit Nr. 05/L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-139 Për Procedurën Përmbartimore, gjeti se prapësimi i debitorit është i bazuar dhe se urdhri përmbartimor duhet të anulohet dhe procedura përmbartimore të përfundohet në tërësi për shkaqet si në vijim:

Gjykata vlerëson se në rastin konkret Fatura Nr.001180 e datës 03.03.2016, në bazë të së cilës është lejuar urdhri përmbartimor, nuk i plotëson kushtet e parapara me nenin 29 dhe nenin 37 të LPP-së.

Sipas nenit 29 paragrafit 1 të LPP-së, përcaktohet se *“Përmbartimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”* dhe me paragrafin 3 të të njëjtit nen, përcaktohet se *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbartim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar “, ndërsa me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se “Kur propozimi për përmbartim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.”,*

Gjykata duke u bazuar në të lartcekurat gjeti se dokumenti - Fatura Nr.001180 e datës 03.03.2016, në bazë të së cilës është lejuar propozimi përmbartimor nuk i plotëson kushtet ligjore për të qenë dokument i besueshëm, për faktin se fatura në rastin konkret është lëshuar në mënyrë të njëanshme nga ana e kreditorit dhe nuk është pranuar nga debitori, përkatësisht e njëjta nuk përmban as nënshkrimin e pranuesit – debitorit dhe nuk ka dëshmi se e njëjta është pranuar nga debitori. Andaj, duke qenë se debitori nuk e ka pranuar në mënyrë të rregullt faturën, si e

tillë e njëjta nuk mund të shërbej si dokument i besueshëm dhe nuk ka tipare të përmbareshmërisë.

Gjykata mori parasysh udhëzimet e Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkallës së Dytë, për verifikimin e bazës, përkatësisht kontratës për licencën, mbi të cilat janë lëshuar këto fatura mirëpo vlerësoi se nuk mund të lëshohet në shqyrtimin e kontratës duke pasur parasysh se në procedurën përmbareshmërisë vlen parimi i “formalitetit rigoroz” i përcaktuar me nenin 37 të LPP i cili parasheh se: *“Kur propozimi për përmbareshmërisë paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit”*. Kjo gjykatë vlerëson se kompetencat e gjykatës në rastin e shqyrtimit për përmbareshmërisë kufizohen në vlerësimin e kushteve ligjore të përcaktuara me dispozitën e sipërcituar.

Në rastin konkret nga shkresat e lëndës rezulton se propozimi për përmbareshmërisë është iniciuar mbi bazën e dokumentit përkatësisht Faturën Nr.001180 të datës 03.03.2016, e cila faturë nuk i plotëson kushtet e përcaktuara për zbatimin e përmbareshmërisë në bazë të dokumentit të besueshëm edhe për faktin se e njëjta nuk i përmban elementet të cilat kërkohen sipas nenit 29 paragrafi 3 i LPP-së me të cilin përcaktohet se *“dokumenti i besueshëm është i përshatshëm për përmbareshmërisë po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbareshmërisë së detyrimit monetar”*, sepse fatura mbi bazën e të cilës është lejuar urdhri përmbareshmërisë nuk përmban objektin e qartë të detyrimit, tek pjesa e përshkrimin përmban vetëm përshkrimin “pagesë e taksës për licencë” mirëpo nuk mund të përcaktohet se për cilën periudhë është kërkuar pagesa e kësaj takse, përkatësisht për cilën periudhë kohore është krijuar ky detyrim, andaj si e tillë nuk mund të jetë dokument i besueshëm dhe nuk mund t’i nënshtrohet procedurës përmbareshmërisë.

Andaj duke u bazuar në të lartcekurat gjykata vlerëson se në rastin konkret dokumenti i besueshëm, mbi të cilin mbështetet propozimi për përmbareshmërisë, e mbi bazën e të cilit Përmbareshmërisë privat ka lejuar përmbareshmërisë, nuk ka tipare të përmbareshmërisë dhe si rrjedhojë edhe urdhri i lejuar nga ana e përmbareshmërisë duhet të anulohet.

Nisur nga fakti se në rastin konkret gjykata ka aprovuar prapësimin e debitorit duke u bazuar në nenin 12 paragrafin 2 të Ligjit Nr.05/L-118 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.04/L-139 për Procedurën Përmbareshmërisë, me të cilin përcaktohet se: *“Në rast se e aprovon*

prapësimin, gjykata varësisht nga rrethanat e rastit e përfundon përmbarimin në tërësi ose pjesërisht dhe i anulon veprimet e kryera”, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi, dhe e përfundoi në tërësi procedurën e përmbarimit.

Gjykata në kuptim të nenit 71 par. 1.1 dhe 73 të LPP-së, nenit 12 par. 2 të Ligjit Nr. 05/L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore si dhe nenit 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë-Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.23/24, datë 29.04.2024

Gjyqtarja

Verona Dibra

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.